



МОХИМ - DHP НУК КА КТИМ ТË TVSH-СË НДАЈ КОМПАНИВЕ ПËР ТË CILAT FLISTE OPOZITA

Drejtoria për të hyra publike i mohon fuqishëm pretendimet e OBRM-PDNjKM-së, në të cilën kushedi sa herë prezantojnë të pavërteta për funksionimin e Drejtorisë për të hyra publike dhe në këtë mënyrë tentojnë të dëmtojnë punën e DHP-së.

Rastet për të cilat sot foli Stoilkovski nuk janë pjesë e aferës së paraqitur nga e hëna.

Lidhur me tatimpaguesit e treguar, të prezantuar nga OBRM-PDNjKM, ju njoftojmë se DHP nuk ka bërë rimbursim siç thuhet nga OBRM-PDNjKM-ja.

Lidhur me tatimpaguesit e treguar, të cilët janë prezantuar nga OBRM-PDNjKM-ja, ju njoftojmë se pas kontrolleve të kryera nga DHP, janë ndërmarrë të gjitha procedurat.

Detyruesit kanë dorëzuar deklarata tatimore me pretendime tatimore - paradhënie të mbeturat për periudhat e ardhshme, (dhe jo kërkesat për rimbursim siç janë bërë publike).

Shuma prej 22,000.000 euro e cila përmendet nga OBRM-PDNjKM është një shumë e publikuar në listën e debitorëve, e cila në fakt paraqet borxh tatimor dhe jo rimbursim dhe bazohet në një kontroll të kryer për të kërkuar rimbursim të TVSH-së.

Gjithashtu informojmë se janë kërkuar të dhënat për dokumentet e udhëtimit që janë të shënuara në historikun e ndryshimeve në Regjistrin Qendror të RMV-së dhe është njoftuar edhe Drejtoria e policisë financiare për shqyrtimin dhe veprimet e mëtejshme të tyre.

I bëjmë apel publikut që të mos bie në këto manipulime dhe të ndjekë vetëm informacionet zyrtare që vijnë nga institucionet kompetente. Drejtoria e të hyrave publike përbëhet nga profesionistë të cilët e njohin shumë mirë punën e tyre dhe marrin masat e duhura për çdo tentativë kundërvajtjeje në përputhje me kompetencat e tyre.